

Vendim nr. 262 datë 22.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHPRESA MALOKU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-404 (69), datë 05.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Vjehrra e kërkueses në datën 14.12.2004 ka disponuar me testament pasuritë e saj në favor të tre djemve, por duke iu lënë atyre pjesë të ndryshme. Pas vdekjes së trashëgimlënëses, një prej djemve së bashku me dy fëmijët e tij ka ngritur padi në gjykatë, me objekt pavlefshmërinë absolute të testamentit. Në kushtet kur një prej pasurive ishte tjetërsuar

tek kërkuesja me anë të dhurimit, paditësi trashëgimtar dhe dy fëmijët e tij kanë thirrur si të paditur edhe kërkuesen.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6949, datë 16.06.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke deklaruar të pavlefshëm testamentin vetëm për pjesën që i përket rezervës ligjore të dy fëmijëve të mitur, nipërit e trashëgimlënësës dhe duke urdhëruar edhe regjistrimet përkatëse në regjistrin e pasurive. Sipas asaj gjykate, në kushtet kur trashëgimlënësja me anë të testamentit i ka lënë djalit të saj paditës vetëm pasuri të luajtshme dhe asnjë pasuri të paluajtshme, atëherë bazuar në nenet 379 dhe 361, paragrafi i dytë, të Kodit Civil (KC), ai konsiderohet i përjashtuar nga trashëgimia dhe dy fëmijët e tij të mitur përfitojnë pjesën e tij me zëvendësim nga rezerva ligjore.

3. Mbi bazën e apeleve të paraqitura nga të gjitha palët, përfshirë edhe kërkuesen, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2146, datë 02.11.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin tërësisht të kërkesëpadisë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se trashëgimtari paditës nuk është përjashtuar nga trashëgimia, nuk ka vdekur, nuk është shpallur i padenjë dhe as nuk ka hequr dorë nga trashëgimia, ndaj sipas nenit 361, paragrafi i dytë, të KC-së nuk mund të flitet për prekje të rezervës ligjore dhe testamenti nuk mund të cenohet.

4. Trashëgimtari paditës dhe dy fëmijët e tij kanë paraqitur rekurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-404 (69), datë 05.02.2025, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të dytë, me arsyetimin se për zbatimin e duhur të ligjit material për vlefshmërinë e testamentit duhej përsëritur hetimi gjyqësor për t'u dhënë përgjigje pretendimeve nëse trashëgimtari paditës ishte ose jo i përjashtuar nga trashëgimia dhe nëse ishte person i paaftë për punë, për të konkluduar më pas nëse përfitonin dy fëmijët e tij të mitur me anë të rezervës ligjore.

5. Në datën 18.09.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykatës*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.1. *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar shkelje të ligjit material ose procedural që kërkojnë hetim të ri, por ka

kërkuar rivlerësimin e provave dhe të fakteve nga gjykatat më të ulëta, çka del përtej kompetencave të saj.

- 6.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi pas 12 vjetësh Gjykata e Lartë e ka kthyer çështjen në pikën fillestare, pa udhëzime të qarta e të detyrueshme për gjykatën e apelit, në kundërshtim me nenet 486 dhe 493 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Udhëzimi i Gjykatës së Lartë për përsëritjen e hetimit gjyqësor, rishqyrtimin e provave dhe sqarimin e vullnetit të testatores për përjashtimin ose jo të të birit nga trashëgimia është absurd, pasi testatorja ka ndërruar jetë, ndërsa testamenti noterial përbën një akt të mbrojtur me forcën e ligjit nga neni 337 i KC-së.
- 6.3. *Parimi i drejtësisë efektive*, pasi në kushtet kur nuk diktohej nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e provave, bazuar në nenin 485 të KPC-së, Gjykata e Lartë duhej ta kishte zgjidhur vetë çështjen.
- 6.4. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi kthimi i çështjes për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë ka shkaktuar zvarritje të pajustificuar të procesit pa pasur një vendim përfundimtar për çështjen brenda një afatit të arsyeshëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin

përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

10. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, kërkuesja në objektin e ankimit kushtetues individual ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të datës 05.02.2025 të Gjykatës së Lartë, me të cilin çështja e saj është kthyer për rigjykim në gjykatën e apelit. Nuk rezulton që kërkuesja të ketë parashtruar ndonjë argument bindës se kthimi i çështjes për rigjykim të ketë sjellë pasoja të drejtpërdrejta në të drejtat kushtetuese të saj, të cilat nuk mund të riparohen gjatë procesit që po zhvillojnë gjykatat e zakonshme. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkuesja ka ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur pretendimet e saj për të drejtat që pretendon se i janë shkelur, prandaj ankimi që lidhet me atë vendim nuk plotëson kriterin për shterimin e mjeteve juridike efektive.

12. Gjithashtu, kërkuesja ka kërkuar edhe konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes së vlefshmërisë së testamentit, me argumentin se kthimi i çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë e zgjat edhe më tej procesin gjyqësor.

13. Lidhur me këtë kërkim, Kolegji sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të

ndryshuar”, sipas të cilëve, individët kanë dispozicion mjetin juridik të kërkesës që u drejtohet gjykatave të zakonshme për përshpejtimin e procedurave dhe konstatimin e shkeljes (nenet 399/1 e vijues të KPC-së). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vëren se kërkesja nuk i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues individual ndonjë akt që të provojë se ka përdorur mjetet ligjore që ka pasur në dispozicion. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Për sa më lart, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji çmon se kërkesja nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës dhe se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.